REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE DHE BUXHETIT

SEKTORI I PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT

Nr._____Prot. **Bilisht më, 24.06.2025**

PROJEKT-VENDIM

Nr.37 datë 24.06.2025

RISHIKIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025

Bazuar ne ligjin nr.139/2015 për "Vetqeverisjen Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, neni 64 gërma c i ndryshuar, ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr.68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" neni 46, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", pika 101, ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025":

PROPOZOJ

1. Njohjen e shpenzimeve qË do të kryhen gjatë gjysmës së dytë të vitit 2025 si më poshtë:
   - I. Kuotë vjetore për Shoqatën Kombëtare të Bashkivë në vlerën 423,000 lekë.
   - II. Bashkëfinancim për objektin "Rehabilitimi i terreneve sportive të shkollës së mesme Fuat Babani, Bilisht" në vlerën 3,405,000 lekë.
   - III. Supervizim objekti "Rehabilitimi i terreneve sportive të shkollës së mesme Fuat Babani, Bilisht" në vlerën 458,061 lekë.
   - IV. Kolaudim objekti "Rehabilitimi i terreneve sportive të shkollës së mesme Fuat Babani, Bilisht" ne vlerën 42,000 lekë
   - V. Blerje materiale elektrike në vlerën 500,000 lekë.
   - VI. Zhvillimi i aktivitetit kulturor "Verë dhe Portokalle" në vlerën 1,000,000 lekë.
   - VII. Transfertë për Klubin e Futbollit në vlerën 2,000,000 lekë.

Adresa:Bashkia Devoll,Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9,Tel& Fax +35581123815-22288, e-mail bashkiadevoll@gmail.com.ëeb.http://bashkiadevoll.gov.al/

VIII. Auditim paraprak i eficiencës energjitike për projektin "Rikonstruksion i shtëpisë muze Dritëro Agolli" në vlerën 87,199 lekë.

IX. Oponencë teknike për projektin "Rikonstruksion i shtëpisë muze Dritëro Agolli" në vlerën 62,824 lekë.

X. Blerje shtretër për cerdhen e qytetit në vlerën 120.000 lekë.

2. Për përballimin e këtyre shpenzimeve propozojmë pakësimin e fondeve si më poshtë:

Gr.	Kap.	Titull	Programi	Kodi i Produktit	Shuma	Pershkrimi
00	01	600	AA105	V111AAA	6,978,023	Paga
00	01	601	AA105	V111AAA	1,120,061	Sigurime Shoqërore
TOTALI I PAKESIMEVE					**8,098,084**	

3. Sipas natyrës së shpenzimit fondet do të klasifikohen me analizë si më poshtë:

Gr.	Kap.	Titull	Prog.	Kodi I Produktit	Shuma	Pershkrimi
00	01	602	AA105	V111AAD	423,000	Kuote vjetore
00	01	231	AD105	V923AAB	3,405,000	Bashkefinacimi
00	01	231	AD105	V923AAB	458,061	Supervizim objekti
00	01	231	AD105	V923AAB	42,000	Kolaudim objekti
00	01	602	AB105	V644AAB	500,000	Materiale elektrike
00	01	602	AD105	V823AAC	1,000,000	Aktivitet kulturor
00	01	604	AD105	V813AAC	2,000,000	Transf. K.Futbollit
00	01	231	AD105	V822AAD	87,199	Auditim I E.Energjitike
00	01	231	AD105	V822AAD	62,824	Oponence teknike
00	01	602	AD105	V043AAC	120,000	Blerje Shtreter per Cerdhe
TOTALI I SHTESAVE					**8,098,084**	

4. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Drejtuesit e Ekipeve të Programeve dhe Sektori Juridik dhe Prokurimeve për zbatimin e këtij projekt-vendimi.

Konceptoi :Drejtore e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit

Aurela FURXHI

Miratoi bazën ligjore: Përgj. e Sektorit Juridik dhe Prokurimeve

Eriksela AVDO

KRYETARI I BASHKISË

Eduard DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DEVOLL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE DHE BUXHETIT

SEKTORI I PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT

Nr.1038 Prot. **Bilisht më, 24.06.2025**

RELACION

MBI

PROJEKT-VENDIMIN PËR "RISHIKIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025"

Bazueshmëria ligjore:

Ligjin nr.139/2015 për "Vetqeverisjen Vendore" i ndryshuar.
Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, neni 64 gërma c i ndryshuar.
Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
Ligjit nr.68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" neni 46.
Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", pika 101.
Ligjit nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025":

Argumentimi i propozimit:
Njësitë e vetëqeverisje vendore, kanë të drejtë, sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore dhe financat e vetëqeverisjes vendore, të kryejnë rishikimin e buxhetit të miratuar në përputhje me realizimin e të ardhurave dhe me ndryshimin e prioriteteve gjatë vitit. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda datës 30 qershor analizon zbatimin e buxhetit dhe i propozon këshillit të njësisë ndryshimin e buxhetit, në rast se është e nevojshme. Ndryshimi i buxhetit gjatë vitit do të ndjekë të njëjtën rrugë proceduriale të miratimit të buxhetit në fillim të vitit. Në këtë moment si kërkesa të reja për buxhetin e vitit 2025 janë paraqitur si më poshtë:

- Kuotë vjetore për Shoqatën Kombëtare të Bashkivë në vlerën 423,000 lekë sipas shkresës nr.452 date 03.03.2025.
- Bashkëfinancim për objektin "Rehabilitimi i terreneve sportive të shkollës së mesme Fuat Babani, Bilisht" në vlerën 3,405,000 lekë. Me shkresen nr.2174/1 datë 09.04.2025 jemi njoftuar për financimin e projektit të terreneve sportive të shkollës së mesme projekt i cili shkon në vlerën 34,373,784 lekë. Ky projekt është bashkëfinancim me Bashkinë Devoll në masën 15%

Adresa:Bashkia Devoll,Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9,Tel& Fax +35581123815-22288, e-mail bashkiadevoll@gmail.com.ëeb.http://bashkiadevoll.gov.al/

përkatësisht 5,156,068 lekë. Projekti shtrihet në dy vite financim dhe Bashkia Devoll ka detyrimin të planifikojë 20% të vlerës. Nga mundësitë tona financiare ne kemi planifikuar një shumë më të madhe së pjesa 20% për të vijuar sa me mirë ecuria e projektit. Detyrimi ynë është edhe planifikimi i supervizimit dhe kolaudimit të objektit e përllogaritur nga sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me kërkesën nr.2031 datë 23.06.2025 për vlerën supervizim 458,061 lekë dhe kolaudim 42,000 lekë.

- Blerje materiale elektrike në vlerën 500,000 lekë është kërkesë e agjencisë së Shërbimeve Publike me nr.122 datë 23.06.2025 për blerjen e materialeve të cilat nevojiten për linjat e rreja që do te riparohen ne fshatin Bitincke por edhe ne fshatra te tjere per shkak te ndryshimeve qe po behen nga OSHEE .
- Zhvillimi i aktivitetit kulturor "Verë dhe Portokalle" në vlerën 1,000,000 lekë eshte kerkuar nga Drejtoria e Arsim Kultures nepermjet kerkeses te paraqitur date 30 Prill nga organizata jofitimprurese UTILIS per zhvillimin e aktivitetit kulturor dhe humoristik me trupen e aktoreve te njohur te spektaklit te mirenjohur "Portokalli". Aktivitetit parashikohet te realizohet ne daten 20 Korrik 2025 dhe ka per qellim aktivizimin e jetes kulturore dhe artistike ne qytet.
- Transferte për Klubin e Futbollit në vlerën 2,000,000 lekë. Duke analizuar detyrimet dhe realizimin e buxhetit deri ne kete moment për Klubin Sportiv e shohim të nevojshme planifikimin e shumës 2.000.000 lekë për fillimin e ndeshjeve në muajin Shtator. Nga miratimi deri në këtë moment që flasim plani i parashikuar në buxhetin fillesatar të vitit 2025 është realizuar 100%.
- Nga ana e sektorit te BE eshte kerkuar fondi per auditim paraprak te eficences energjitike dhe oponence teknike per projektin "Rikonstruksion I shtepise muze Dritero Agolli" per vleren totale 150,023 lekw sipas shkresen nr.2095 datte 27.06.2025

Këto janë identifikuar si shpenzime emergjente që sjell rishikimin e buxhetit. Pakësimi i fondeve për këto shpenzime është parashikuar të ndodhë në paga dhe sigurime shoqërore për pozicionet të cilat deri në këtë moment kanë qënë vakante por edhe do të vashdojnë të jenë të pa plotësuara. Këtu mund të përmendim përgjegjës sektori në Planifikimin e Buxheti, përgjegjës sektori në Menaxhimi Financiar, drejtor i shërbimeve Juridike dhe Prokurimeve, drejtor në Urbanistikë, dhe dy specialistë në Urbanistikë. Në total fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore që parashikohen të pakësohen shkon në vlerën **8,098,084** lekë.

Faleminderit!

Konceptoi :Drejtore e Shërbimeve Financiare dhe Buxhetit

Aurela FURXHI

KRYETARI I BASHKISË

Eduard DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DEVOLL